

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-142/14

Prishtinë, 3 Shkurt 2016

Në çështjen juridike të:

S. J.

Pala ankuese

Kundër

Z. S.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (ne tekstin e mëtejme: KKPK) nr.KPCC/D/A/106/2011 i datës 13 Maj 2011 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës: AKP me numer KPA36442) dhe nr. KPCC/D/A/219/2013 datës 27 Nëntor 2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA36439 dhe KPA36440, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 3 Shkurt 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga S. D., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A142/14, GSK-KPA-A-143/2014 dhe GSK-KPA-A-144/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-142/2014
2. Ankesat e paraqitura nga S. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013 date 27 Nëntor 2013 GSK-KPA-A-142/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA36439 dhe KPA 36440) dhe nr. KPCC/D/A/106/2011 13 Maj 2011 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA36442) refuzohen si të pabazuara.
3. Konfirmohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013 date 27 Nëntor 2013 dhe nr. KPCC/D/A/106/2011 date 13 Maj 2011 sa u përket kërkesave me numrat KPA36439, KPA3640 dhe KPA36442.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 7 Maj 2007, Z. S., (në tekstin e mëtejshëm: pale përgjegjëse në ankese) ka paraqitur tri kërkesa individuale në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon të drejtën pronësinë në 1/3 e pjesës ideale të ngastrave:
 - Nr. 1207, Zona kadastrale Jasenovik, Novo Brdo me sipërfaqe prej 4 ari e 38 metra²;
 - Ngastra nr.1202 Zona kadastrale Jasenovik, Novo Brdo me sipërfaqe prej 9 ari 90 metra² dhe
 - Ngastrës kadastrale nr.1203 Zona kadastrale Jasenovik, Novo Brdo me sipërfaqe prej 7 ari e 68 metra katrorë (tani e tutje: pronat e kërkuara).
2. Në këto kërkesa ajo kishte theksuar se pronat e kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, ku përmendet data 12 qershor 1999 si data e humbjes.
3. Për të mbështetur kërkesat e saj kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Fletën poseduese nr. 27 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunes së Novo Brdos të datës 18 Tetor 2005, që tregon se pronat e kërkuara ishin të regjistruara në emër të S. D.;

- Aktvendimin trashëgimor T. Nr. 249/89 i datës 10 Janar 1990 me të cilin paraqitësja e kërkesës deklarohet pronare e 1/3 të pronave të kërkuara si trashëgimtare pas vdekjes së S.D. në 15 Shtator 1987;
- Letërnjoftim lëshuar nga autoritet kompetente me 30 Gusht 2001.

Nga dokumentet e tjera të dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankese dhe nga dokumentet e dorëzuara nga S.D. (ketu me tutje: pala ankuese), del që S. D. ishte djali i S. D. dhe se S. D. ishte i martuar me J. D. dhe se S. D. kishte dy vajza dhe njëra prej tyre është pala përgjegjëse në ankese.

4. Sipas Fletës Poseduese nr.27 të datës 8 Janar 2011, nga të dhënat e Qendrës për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Novobërdë, ngastrat kadastrale të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës e që ndodhen në zonën kadastrale të Jasenovikut, janë të regjistruara në emrin e S. D. si më poshtë:

Numri i ankesës dhe numri i kërkesës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-142/14 (KPA36442)	Ngastra nr.1207, në vendin e quajtur “Padina”, arë e klasit të 5-të dhe 7-te me sipërfaqe prej 0.29.34 dhe 0.04.38 ha
GSK-KPA-A- 143/14 (KPA36439)	Ngastra nr. 1202, në vendin e quajtur “Oborishte”, shtëpi ndërtesë me sipërfaqe prej 0.09.90 ha dhe dy pjesë nga 00.01.93 dhe 00.05.00 ha
GSK-KPA-A-144/14 (KPA36440)	Ngastra nr. 1203, në vendin e quajtur ” Oborishte”, arë e klasit të 5-të me sipërfaqe prej 00.07.78 ha

5. AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës KPA36442 në 14 Janar 2008 dhe me vone, pasi arritën në përfundimin se njoftimi i parë nuk ishte bërë në rregull, në 30 Gusht 2010 nëpërmjet publikimit në gazetën e njoftimeve të AKP-së nr.7. Pas këtij njoftimi askush nuk mori pjesë në procedurën në shkallë të parë.
6. Kërkesa me nr.KPA36439 është njoftuar në 15 Janar 2008 dhe në 18 Maj 2008. AKP-ja e gjeti atë të uzurpuar nga pala ankuese i cili pretendon se ka të drejtë pronësie mbi atë ngastrë.
7. AKP-ja njoftoi kërkesën me nr.KPA36440 në 1 Korrik 2008 dhe 2 Mars 2010. Gjithashtu dhe për ngastrën në këtë kërkesë pala ankuese kërkonte të drejtën e pronësisë.
8. AKP-ja konstatoi se pronat në kërkesat KPA36439 and KPA36440 ishin identifikuar si duhet nëpërmjet ortofotove dhe koordinatave GPS.

9. Më 25 Gusht 2008, pala ankuese i është përgjigjur kërkesave me numër KPA36439 dhe KPA36440 dhe ka pohuar se është familjar-kushëri i palës përgjegjëse ne ankese, se ai po shfrytëzon ngastrat ne këto kërkesa dhe se ato janë pronat e trashëguara nga i ndjeri S. D., gjyshi i tij. Veç kësaj, ai deklaroi se ai e ka kundërshtuar vendimin e Komisionit lidhur me një kërkesë tjetër me numër KPA36452 dhe Gjykata Supreme e ka aprovuar ankesën e tij dhe e ka refuzuar kërkesën e Z. S.
10. Në mbështetje të pretendimeve të tij pala ankuese ka paraqitur si vijon:
- Deklarate e dhene me shkrim e datës 14 Prill 2014;
 - Kopje te padisë dorëzuar nga pala ankuese ne Gjykatën Komunale ne Prishtinë kundër palës përgjegjëse ne ankese për pengim në mbajtje dhe posedim;
 - Tapi e datës 16 Prill 1938;
 - Aktgjykim i gjykatës komunale në Prishtinë C.Nr. 1935/08 i datës 25 Maj 2010 me te cilin refuzohet kërkespadia e palës ankuese;
 - Letërnjoftime dhe certifikata vdekje qe deshmojne lidhjen e trungut familjar me gjyshin e vet S. D., xhaxhain e vet S. D., J. D. dhe gruan e S. D., pala përgjegjëse ne ankese dhe pala ankuese.
11. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së, të datës 20 janar 2011, fleta poseduese nr.27, aktvendimi i trashigimisë dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë janë verifikuar pozitivisht.
12. Vendimi i KKPK-së i nr. KPCC/D/A/106/2011 i datës 13 Maj 2011 konfirmoi se pala përgjegjëse ne ankese ka dëshmuar se ka pronësi në pjesë ideale prej 1/3 të pronës së kërkuar në kërkesën KPA36442 dhe se i njejti është bërë i formës së prerë për arsye se askush nuk kishte marr pjesë në procedurën e shkallës së parë.
13. KKPK-ja ne vendimin e tij nr. KPCC/D/A/2019/2013 i datës 27 Nëntor 2013 për kërkesat KPA36439 dhe KPA36440 konfirmon se pala përgjegjëse ne ankese, ka dëshmuar se ka pronësi në pjesë ideale prej 1/3 të pronave të kërkuara me atë kërkesë. KKPK-ja gjithashtu arsyetoi se pala ankuese nuk ka provuar se Aktvendimi i trashëgimisë nuk ishte i vlefshëm dhe se ai nuk ofroi ndonjë prove për te provuar te drejtën e tij te pronësisë.
14. Vendimi KKPK-se nr. KPCC/D/A/106/2011 date 13 Maj 2011(lënda e regjistruar ne AKP me numër KPA36422 iu dorëzua palës përgjegjëse ne ankese ne 14 Tetor 2010. Pala ankuese ka paraqitur një ankese kundër këtij vendimi ne 14 Prill 2014.

15. Vendimi i KKPK-se lidhur me kërkesat nr.KPA36440 dhe KPA 36439 i është dorëzuar palës ankuese ne 18 Mars 2014 dhe palës përgjegjëse ne ankese ne 22 Maj 2014. Pala ankuese paraqiti ankese kundër këtij vendimi ne date 10 Prill 2014.
16. Palës përgjegjëse ne ankese i janë dorëzuar ankesat, por ai nuk ka dërguar përgjigje ndaj ankesave.

Pretendimet e palës ankuese

17. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së nuk e ka marrë në konsideratë faktin se pala ankuese ka paraqitur një padi ne Gjykatën Komunale ne Prishtine dhe se pas refuzimit te kërkesës se saj nga kjo gjykate, ai paraqiti një ankese kundër vendimit te Gjykatës Komunale ne Prishtine se kjo gjë mund ta ndryshoi raportin e bashkëpronësisë midis palëve.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

18. Ankesat kundër vendimit te KKPK-se nr. KPCC/D/A/219/2013 është dorëzuar brenda 30 ditëve nga momenti qe AKP i ka dorëzuar vendimin palës ankuese, ashtu siç parashikohet ne Seksionin 12.1 te Rregullores se UNMIK 2006/50 Mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-79(këtu e me tej: Ligji nr.03/L-079) janë te pranueshme.
19. Pala përgjegjëse ne ankese nuk ka marrë pjesë në procedurën për kërkesën nr.KPA36442. Gjykata Supreme konsideron se publikimi i kërkesës nëpërmjet Gazetës Zyrtare te AKP-se ne baze te praktikës se vendosur nga Gjykata Supreme është përpjekje jo e mjaftueshme e bere nga ana e AKP-se për njoftimin e kërkesës për palët e interesuara. Fakti qe pala përgjegjëse ne ankese është pale e interesuar ne këtë kërkesë, nuk është kontestuese. Duke qene se pala ankuese nuk ishte njoftuar siç duhet për kërkesën përpara KPA/KPCC fakti se ai nuk mori pjese ne procedurat përpara KKPK-se nuk e ndalon pjesëmarrjen e tij ne proceduren ne shkalle te dyte. Për këtë arsye, Gjykata Supreme konsideron ankesën te pranueshme për vendimin e KKPK-se nr.KPCC/D/A/106/2011 date 13 Maj 2011(lënda e regjistruar ne AKP me numër KPA36442)

Bashkimi i ankesave

20. Ne përputhje me nenin 13.4 i Ligjit Nr.03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendose mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga KPCC në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i lejon KPCC të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr vendime aty ku ka çështje të njëjta ligjore si dhe të provave.
21. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (ligji nr.03/L006) që janë të zbatueshme *mutatis mutandis* nëse nuk parashikohet ndryshe në procedura para Kolegjit të Apelit të AKP-se se Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Neni 408.1 në vështrim të nenit 193 të Ligjit nr. 03/L006 të Procedurës Kontestimore, ofrojnë mundësinë e bashkimit të ankesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efikasitetin e gjykatës dhe efektshmërinë e lëndës.
22. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm që janë paraqitur ankesat, faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë saktësisht të njëjta në të dyja lëndët. Vetëm ngastrat, janë të ndryshme. Ankesat janë të bazuara në deklaratë të njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat në thelb është i njëjtë.
23. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-142/2014, GSK-KPA-A-143/2014 dhe GSK-KPA-A-144/14 bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-142/2014.

Meritat e ankesës

24. Gjykata Supreme e Kosovës vëren se në bazë të dokumentacionit të siguruar nga pala ankuese dhe raporteve të verifikimit të AKP-se, KPCC ka vlerësuar si drejtë se humbja e posedimit mbi pronat e kërkuara ishte rezultat i lidhshmërisë me rrethanat e konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999. Pala ankuese deklaroi duke ofruar një deklaratë të mamasë se saj se ato i braktisen pronat e kërkuara në fund të luftës për arsye sigurie ndërthurur me problemet shëndetësore të mamasë se saj. Për më tepër, pala ankuese ka pranuar se në atë kohe ai ka marrë çelësat e pronave të kërkuara për t'u kujdesur për to, por ai e ka marrë posedimin mbi këto prona në vitin 2000.
25. Për më tepër KKPK-ja ka vendosur në mënyrë korrekte kur ka konfirmuar pronësinë e palës përgjegjëse në ankesë.. AKP-ja verifikoi pozitivisht Aktvendimin e trashëgimisë. Ky dokument provon se pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë për të drejtën e pronësisë mbi pronat e

- kërkuara. Ne anën tjetër KKPK-ja ka vendosur ne mënyrë korrekte se pala ankuese nuk ka provuar ndonjë të drejte pronësie mbi pronën e kërkuar.
26. Gjkata Supreme gjeti se KKPK- në Vendimin e vet KPCC/D/A/219/2013 të datës 27 Nëntor 2013 në paragrafët 48 dhe 66-88 ka dhënë arsyetimin se pala ankuese kishte dëshmuar mbi bazën e dokumenteve të parashtruara se është pronare e 1/3 së pronës së kërkuar dhe këto dokumente ishin verifikuar pozitivisht.
 27. Në paragrafin 67 të atij vendimi është specifikuar se pala ankuese ishte kushëri i palës përgjegjëse në ankese dhe se prona e kërkuar ishte trashëguar nga gjyshi i tij. Për këtë, pala ankuese ai kishte iniciuar një procedurë në Gjykatën Komunale të Prishtinës për të vërtetuar se ai ishte trashëgimtar i gjyshit të tij. Vendimi i shkallës së parë ishte refuzues për palën ankuese. Për këtë arsye ai nuk mundi të siguroje prova se Aktvendimi i trashëgimisë i dorëzuar nga pala ankuese është i pavlefshëm. Edhe pse procedura e ankimit kundër këtij vendimi nuk është përfunduar ende, kjo nuk te çon në konkluzionin se pretendimet e tij mbi pavlefshmërinë e Aktvendimit të trashëgimisë janë të drejta.
 28. Pala ankuese nuk e mohon mosmarrëveshjen rreth çështjes trashëgimorë midis kushërinjve por me asnjë provë nuk mundi të dëshmoi se ka pas ndonjë të drejtë mbi pronën e kërkuar. Ai kërkoi që Gjykata Supreme të konstatoi se KKPK-ja nuk e ka marrë në konsiderate se procedura para gjykatës nuk ka përfunduar. Kjo kërkesë nuk te çon në një tjetër vendim mbi këtë ankese përpara Kolegjit të Ankesave të AKP-se në Gjykatën Supreme, sepse nuk ka asnjë parashikim në ligj që te detyroje KPCC te prese për një vendim të tillë.
 29. Në vijueshmëri të gjithë kësaj Gjykata Supreme gjen se në vendimin e KKPK-ës nuk janë përfshirë shkelje të së drejtës materiale, si bazë tjetër reale e pretenduar dhe e theksuar për paraqitjen e ankesës nga ana e ankuesit. Gjykata Supreme arrin në përfundimin se pala ankuese nuk ka treguar ndonjë baze reale për një ankese të suksesshme nga ana e palës ankuese.
 30. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marr vendim të drejtë, të bazuar në një procedurë të plotë dhe të saktë. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim të gabuar ose jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.
 31. Nga arsyet e paraqitura e sipas nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

32. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it